



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT  
KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. 2927 Prot.

Tiranë, më 16.05.2024

V E N D I M

Nr. 28, datë 16.05.2024

**PËR SKUALIFIKIMIN E KANDIDATES SUIDA LILI, NË PROCEDURËN E PRANIMIT  
NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR, NË KATEGORINË EKZEKUTIVE, PËR  
POZICIONIN SPECIALIST FINANCE**

Në mbështetje të neneve 27, 28, 38 shkronja "b)", 54, 58 dhe 60 të Ligjit nr. 98, datë 06.10.2016 "*Per Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, si edhe të nenit 23, 27, 30, 32 dhe 33 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 622, datë 10.12.2020 "*Per lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor*", Këshilli i Gjykatës,

**KONSTATON**

1. Në përfundim të procedurave të verifikimit paraprak, të realizuar përkatësisht nga Kancelari dhe të vlerësimit me shkrim, të kryer në datën 12.04.2022, nga Komisioni i Pranimit, sipas nenit 27 dhe 30 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 622, datë 10.12.2020 "*Per lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor*", në lidhje me procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor, në kategorinë ekzekutive për pozicionin *Specialist Finance*, Komisioni i Pranimit e ka vlerësuar kandidaten Suida Lili me 46.00 pikë, nga minimumi prej 42 pikë, duke e kualifikuar atë për fazën e intervistës së strukturuar me gojë përpara Këshillit të Gjykatës.
2. Në përfundim të afatit të ankimit lidhur me rezultatet e vlerësimit me shkrim nga Komisioni i Pranimit, në mbështetje të nenit 32, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.622, datë 10.12.2020 "*Per lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor*", Këshilli i Gjykatës e ka ftuar kandidaten Suida Lili për intervistën e strukturuar me gojë, duke marrë parasysh edhe rregullat e pikëzimit të Ankesit 5 të Udhëzimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.85, datë 11.03.2021 "*Per procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur*".
3. Në vijim, bazuar në rregullat dhe orientimet e parashikuara nga Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.622, datë 10.12.2020 dhe Udhëzimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.85, datë 11.03.2021, Këshilli i Gjykatës zhvilloi intervistën e strukturuar me gojë me kandidaten e kualifikuar për këtë fazë, znj. Suida Lili,
4. Në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë, bazuar në procedurat dhe kriteret e vlerësimit sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Këshilli i Gjykatës shqyrtoi dhe bisedoi vlerësimin e kandidates Suida Lili bazuar në dokumentacionin e paraqitur, duke ardhur në përfundimet vlerësuese si më poshtë:

4.1 Për kriterin e arsimimit, vlerësimi i secilit anëtar të Këshillit është 3 (tre) pikë.

4.2 Për kriterin e përvojës në punë, vlerësimi i secilit anëtar të Këshillit është 5 (pesë) pikë.

4.3 Për kriterin e trajnimeve dhe kualifikimeve, vlerësimi i secilit anëtar të Këshillit është 5 (pesë) pikë.

4.4 Nga mbledhja e vlerësimeve të anëtarëve të Këshillit të Gjykatës për kriteret sipas pikave 4.1, 4.2 dhe 4.3, kandidatja Suida Lili u vlerësua në total me 39.00 (tridhjetë e nëntë) pikë.

4.5 Nga përpjestimi i vlerësimit total të anëtarëve të Këshillit prej 39 pikësh, me numrin e anëtarëve (3), vlerësimi i kandidatës Suida Lili është 13.00 (trembëdhjetë) pikë.

5. Këshilli i Gjykatës, pasi zhvilloi intervistën e strukturuar me gojë me kandidaten e kualifikuar për këtë fazë znj.Suida Lili, ka ardhur në përfundimet vlerësuese si më poshtë:

5.1 Për grup-pyetjet nr. 1 (*pyetje përgjigje mbi përvojat e mëparshme dhe ekzistuese profesionale, përvoja të lidhura me natyrën e pozicionit për të cilin kandidon apo përvoja të tjera, sfidat e veçanta profesionale dhe mënyrën e përballimit të tyre në përmbushjen e detyrës*):

5.1.1 Anëtari i parë (Ardian Dvorani) - 1 (një) pikë;

5.1.2 Anëtare e dytë (Blerona Hasa) - 1 (një) pikë;

5.1.3 Anëtari i tretë (Leonard Strataj) - 2 (dy) pikë.

5.2 Për pyetjen nr. 2 (*pyetje përgjigje mbi motivimin për të kandiduar për pozicionin specialist buxheti në Gjykatën Administrative të Apelit*):

5.2.1 Anëtari i parë (Ardian Dvorani) – 2 (dy) pikë;

5.2.2 Anëtare e dytë (Blerona Hasa) - 1 (një) pikë;

5.2.3 Anëtari i tretë (Leonard Strataj) - 2 (dy) pikë.

5.3 Për pyetjen nr. 3 (*pyetje përgjigje mbi mendimin dhe qëndrimin e kandidatit për natyrën e detyrës në pozicionin specialist buxheti, mbi përmbushjen e kësaj detyre nga kandidati në raport me njohuritë dhe përvojën që pretendon se zotëron, si edhe mbi mënyrën e reagimit dhe përballimit të detyrës në situata specifike ngarkese pune apo të presionit*):

5.3.1 Anëtari i parë (Ardian Dvorani) - 2 (dy) pikë;

5.3.2 Anëtare e dytë (Blerona Hasa) - 1 (një) pikë;

5.3.3 Anëtari i tretë (Leonard Strataj) - 2 (dy) pikë.

5.4 Nga mbledhja e vlerësimeve të anëtarëve të Këshillit të Gjykatës për përgjigjet e dhëna gjatë intervistës së strukturuar me gojë, kandidatja Suida Lili u vlerësua në total me 14 (katërbëdhjetë) pikë.

5.5 Nga përpjestimi i vlerësimit total të anëtarëve të Këshillit prej 14 pikësh, me numrin e anëtarëve (3), vlerësimi i kandidatës Suida Lili është 4.66 (katër pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) pikë.

6. Në përfundim, nga mbledhja e pikëve të vlerësimit për secilin kriter, të treguar më sipër në pikat 4 dhe 5 të këtij vendimi, vlerësimi përfundimtar i kandidatës Suida Lili është 63.66 (gjashtëdhjetë e tre pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) pikë.

7. Në kushtet kur kandidatja Suida Lili është vlerësuar me rezultatin përfundimtar prej 63.66 pikësh, sipas nenit 54, të Ligjit nr. 98, datë 06.10.2016 "*Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, si edhe të nenit 32, pika 5, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

nr.622, datë 10.12.2020 "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", konsiderohet i skualifikuar nga procedura e pranimit në shërbimin civil gjyqësor, në kategorinë ekzekutive, për pozicionin Specialist Finance.


8. Për këto arsye, në mbështetje të nenit 54 të Ligjit nr. 98, datë 06.10.2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 32, pika 5 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.622, datë 10.12.2020 "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", Këshilli i Gjykatës,

#### VENDOSI:

1. Skualifikimin e kandidates Suida Lili nga procedura e pranimit në shërbimin civil gjyqësor, në kategorinë ekzekutive, për pozicionin Specialist Finance.
2. Ndaj këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatën kompetente.
3. Ky vendim i njoftohet kandidatit të skualifikuar.

KANCELARI

Leonard STRATAJ



ANËTARE

Blerona HASA



ZËVENDËSKRYETARI

Ardian DVORANI

